



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.420/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Albulena Saliuku, candidate për asamble komunale në Komunën e Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3243-2025, të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.420/2025, e datës 07.11.2025, e parashtruar nga Albulena Saliuku, candidate për asamble komunale në Komunën e Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3243-2025, të datës 05.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 07.11.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.420/2025, nga Albulena Saliuku, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, me të cilën pretendon se ka dyshime serioze mbi anulimin e paarsyeshëm të një numri të votave të dërguara nga diaspora në kuadër të zgjedhjeve lokale 2025. Kanë kërkuar nga PZAP që në pajtim me nenin 113 të LZP-së, Nr.08/L-228, të urdhëroj KQZ-në të paraqes të gjitha dokumentet dhe të dhënat lidhur me votimin me postë, dhe nëse konstatohet parregullsi të urdhëroj rinumërimin të votave. Tutje ka shtuar se votuesit i kanë shprehur bindjen e plotë se e kanë votuar në mënyrë të rregullt dhe të ndershme por se rezultati nuk përkon me vullnetin e shprehur në votim.

Ankesës i ka bashkangjitur deklaratat e votuesve, dhe kopjen e letërnjoftimit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 07.11.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë deklaruar se Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet

procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njoftoj se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve.

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: *17 Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.*

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike. Tutje kanë shtuar se sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë të drejtë. Parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të çarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LPZ-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, dhe pretendimet e ankuesit nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marr më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara. KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe zarfet e dërguar me postë gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e Albulena Sadiku, kandidate për anëtarë të asamblesë komunale kuvendit komunal në Komunën e Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, se “ka

dyshime serioze mbi anulimin e paarsyeshëm të një numri të votave të dërguara nga diaspora” janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se e njëjta nuk ka arritur që të dëshmoj me prova pretendimet e saj, përkatësisht të dëshmoj faktin se i mungojnë këto fletëvotime me postë, të cilat pretendon se kanë votuar, ndërsa ankesës nuk i ka bashkangjitur prova konkrete dhe bindëse, që argumentoj pretendimet e shprehura në ankesë.

Dëshmitë e bashkëngjitura në ankesë dhe atë dy fotografi të zarfeve me të cilat pretendon se janë zarfet të votimit për votuesit jashtë Kosovës, nuk mund të vërtetohet asnjë nga pretendimet ankimore, ndërsa deklaratat e personave të cilët deklarojnë se e kanë votuar, nuk janë prova bindëse dhe konkrete për të vërtetuar se ka ekzistuar shkelja e pretenduar. Paneli vlerëson se pretendimet ankueses janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga pretendimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk e ka dëshmuar me prova konkrete, të ligjshme se të cilat do të provonin pararsyeshmërinë e anulimit të një numri të votave nga diaspora, dhe parregullsinë e numërimit të votave në QNK Drenas si dhe publikim e tyre nga KQZ, pretendimet e ankueses janë më shumë pritshmëri e saj për më shumë vota, e jo që në realitet se ka pasur mungesë të votave.

Duhet cekur se lidhur me deklaratat e votuesve dhe fshehtësisë së votimit, është krijuar tashmë praktika gjyqësore, ngase Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj AA.nr.61/2025 të datës 24.03.2025 kishte konstatuar se: *“deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”.*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë, ankuesi nuk ka arritur që ti provoj.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.420/2025 me datën 10.11.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husaj Rugova

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas neni 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.